

LIGJ
Nr.7650, datë 17.12.1992

**PËR BIRËSIMET E TË MITURVE NGA SHTETAS TË HUAJ DHE PËR DISA NDRYSHIME
NË KODIN E FAMILJES**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Birësimi lejohet vetëm në rast se është në interesin e lartë të të miturit dhe garanton respektimin e të drejtave të tij themelore.

Neni 2

Me qëllim që të ndihmohet, nxitet e mbikëqyret mbrojtja e të miturve nëpërmjet birësimit dhe për të siguruar një bashkëpunim me autoritetet publike kompetente dhe organizmat privatë të njohur, shqiptarë ose të huaj, krijohet Komiteti Shqiptar i Birësimeve.

Neni 3

Komiteti Shqiptar i Birësimeve është organ kolegjal në vartësi të Këshillit të Ministrave dhe ka në përbërje të tij nga një përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Punës, të Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë, Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Rendit Publik, Ministrisë së Financave dhe një pedagog i Fakultetit të Drejtësisë (specialist i së drejtës familjare ose ndërkombëtare), që caktohet me urdhër të titullarit të ministrisë përkatëse.

Komiteti drejtohet nga kryetari që emërohet nga Kryesia e Këshillit të Ministrave. Ai përfaqëson Komitetin Shqiptar të Birësimeve në të gjithë veprimtarinë e tij.

Neni 4

Komiteti ka një Sekretariat ekzekutiv të përhershëm që emërohet nga ky Komitet. Kryetari i Komitetit është njëkohësisht edhe drejtues i Sekretariatit ekzekutiv. Veprimtaria e Komitetit përcaktohet në rregulloren e tij të brendshme.

Neni 5

Komiteti Shqiptar i Birësimeve ka këto kompetenca kryesore:

- a) Harton dhe mban listat e të miturve që mund të birësohen brenda ose jashtë vendit.
- b) Pranon kërkesat e paraqitura nga shtetas shqiptarë ose të huaj që dëshirojnë të birësojnë të mitur dhe i ndihmon ata me qëllim që të plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm.
- c) Kujdeset t'u japë këshillat e nevojshme personave, pëlqimi i të cilëve kërkohet për birësim, dhe të informojë në kohë për pasojat e pëlqimit të tyre dhe të birësimit.
- ç) Bashkëpunon me autoritetet publike dhe private të vendit dhe të huaja për të siguruar mbrojtjen e të miturve.
- d) Zgjedh dhe bën njohjen e organizmave privatë të huaj, me të cilët do të bashkëpunojë.
- dh) Jep pëlqimin për birësimin e të miturit nga personi që ka paraqitur kërkesë për birësim.
- e) Merr masat e nevojshme për t'u kujdesur që birësimet të mos dështojnë.

e) Merr masa të nevojshme për të përjashtuar përfitimet materiale të padrejta në rastin e një birësimi dhe për të penguar rrëmbimin, shitjen ose tregtimin e fëmijëve.

f) Bën propozimet për përmirësimin e legjislacionit në fushën e birësimit në interes të fëmijës.

g) Shkëmben me autoritetet e huaja të ngarkuara me birësimet informacione për legjislacionin kombëtar në fushën e birësimit.

gj) Përbush detyrimet që rrjedhin nga konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare të kësaj fushe, të ratifikuara nga Shqipëria.

h) U kërkon agjencive të vendit dhe të huaja informacion për gjendjen e fëmijës së birësuar në shtetin përkatës, në afate të përcaktuara në marrëveshje me to.

Neni 6

Organizmat privatë të huaj të birësimeve, me të cilat Komiteti Shqiptar i Birësimeve bashkëpunon, duhet;

a) Të jenë njohur nga autoritetet kompetente të shtetit të tyre.

b) Të ndjekin vetëm qëllime jofitimprurëse në kushtet dhe kufijtë e përcaktuar nga autoritetet kompetente të shtetit të tyre.

c) Të drejtohen dhe administrohen nga persona që karakterizohen nga cilësi morale dhe kanë përvojë për të vepruar në fushën e birësimit ndërvendas.

ç) T'u jenë nënshtruar mbikëqyrjes së autoriteteve kompetente të shtetit të tyre për përbërjen, funksionimin dhe gjendjen e tyre financiare.

Neni 7

Për çdo të mitur që është përfshirë në listën e birësimeve, Komiteti Shqiptar i Birësimeve verifikon dhe përgatit një dosje që përmban këto dokumente:

a) certifikatën e lindjes të të miturit;

b) raportin që sjell në një masë të mundshme të dhëna mbi gjendjen psikologjike dhe sociale të të miturit;

c) raportin që sjell të dhëna për gjendjen shëndetësore ekzistuese të të miturit dhe për historinë e tij mjekësore;

ç) mendimin e të miturit për birësimin, në qoftë se ka mbushur moshën dhjetë vjeç;

d) certifikatën e lindjes dhe, sipas rastit, certifikatën e martesës, të zgjidhjes së saj ose të vdekjes së njërit a të dy prindërve biologjikë të të miturit;

dh) raportin që sjell të dhëna për historinë mjekësore të prindërve biologjikë;

e) deklaratën e pëlqimit me shkrim nga personat që duhet të japin pëlqimin për birësimin ose, sipas rastit, vendimin e gjykatës për deklarimin e braktisjes së të miturit.

Neni 8

Para se të jepet pëlqimi për një vatër familjare të përhershme jashtë vendit për një të mitur, Komiteti Shqiptar i Birësimeve duhet të përpiqet të gjejë një familje të tillë në Shqipëri.

Neni 9

Personat që dëshirojnë të birësojnë të mitur shqiptarë, mund të birësojnë vetëm të miturit që figurojnë në listat e Komitetit.

Shtetasit e huaj dhe shtetasit shqiptarë që kanë vendbanimin e tyre jashtë shtetit, nuk mund t'i drejtohen drejtpërdrejt Komitetit. Kërkesa e tyre i paraqitet Komitetit nëpërmjet autoriteteve publike kompetente ose organizmave privatë të parashikuar në nenin 6 të këtij ligji. Kërkesa dhe dokumentet që e shoqërojnë duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe e të legalizuara sipas ligjit të vendit.

Neni 10

Kërkesa e personit që kërkon të birësojë një të mitur, paraqitet në Komitet e shoqërohet me

dokumentet e mëposhtme:

a) certifikatën e lindjes dhe, sipas rastit, të martesës, të zgjidhjes së saj ose të vdekjes së bashkëshortit;

b) certifikatën e gjendjes së tyre gjyqësore;

c) të dhëna për gjendjen e tyre personale, familjare, mjekësore e sociale;

d) një vërtetim të lidhur me mundësinë e personit për të birësuar;

e) një vërtetim për sjelljen e figurën morale të birësuesve, lëshuar nga organet kompetente.

Në kërkesën për birësim personi duhet të parashtojë edhe motivet për të cilat dëshiron të birësojë.

Neni 11

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe të dokumenteve përkatëse, Komiteti i dërgon gjykatës së rrethit dosjen e personit që kërkon të birësojë dhe atë të të miturit që mund të birësohet.

Komiteti i dërgon gjykatës edhe pëlqimin me shkrim për këtë birësim dhe për birësimet ndërvendase si edhe konfirmimin se i mituri nuk ka pasur mundësi të birësohej në Shqipëri në një afat prej 6 muajsh nga dita e regjistrimit në listat e këtij Komiteti.

Neni 12

Gjykata e rrethit mund të deklarojë të braktisur të miturin e strehuar në një institucion të përkujdesjes së tij (shtëpi foshnje, shtëpi fëmije etj.) ose të personit, i cili e ka marrë në përkujdesje, kur babai dhe nëna e të miturit në mënyrë të dukshme nuk janë intresuar për të gjatë një viti, para paraqitjes së kërkesës për deklarimin e braktisjes.

Kur i mituri ka qenë strehuar qysh nga lindja e tij në një institucion, afati prej një viti kufizohet në gjashtë muaj.

Konsiderohen në mënyrë të dukshme të painteresuar për fëmijën e tyre babai dhe nëna që vullnetarisht nuk kanë mbajtur me fëmijën marrëdhënie afektive të nevojshme për rritjen e tij dhe që kanë treguar pakujdesi të rëndë në ushtrimin e të drejtës prindërore.

Kërkesa për deklarimin e braktisjes bëhet nga drejtuesi i institucionit përkatës ku ndodhet i mituri, ose nga personi që e ka në përkujdesje. Kërkesa i dërgohet gjykatës së rrethit, në juridiksionin e së cilës ndodhet institucioni ose vendbanimi i personit që e ka marrë në përkujdesje të miturin.

Gjykata merr vendimin përkatës pas një hetimi të plotë të rrethanave të braktisjes.

Çdo person që ka interes legjitim për mbrojtjen e fëmijës, mund të ndërhyjë në procesin e gjykimit.

Gjykata që deklaron të braktisur të miturin, cakton në të njëjtin vendim edhe mënyrën e sistemimit të të miturit.

Neni 13

Kur i mituri ndodhet në një institucion, për përkujdesjen e tij (shtëpi foshnje, fëmije etj.), prindërit mund të deklarojnë me shkrim se në mbarim të një afati prej një viti, duke filluar nga dita e deklarimit të tyre, fëmija mund të birësohet nga personat që Komiteti do të caktojë, pa qenë e nevojshme marrja e një pëlqimi të ri nga ana e tyre. Pëlqimi i prindërve duhet të vërtetohet me akt noterial.

Gjatë afatit prej një viti prindërit mund të revokojnë në çdo kohë deklarimin e tyre.

Neni 14

Vendimi i birësimit merret nga gjykata. Kërkesa për birësimin e bërë nga një shtetas i huaj ose shqiptar që banon jashtë shtetit, paraqitet në gjykatën e rrethit të vendbanimit të të miturit.

Kërkesa për birësimin e të miturit shqiptar që banon jashtë shtetit, paraqitet në gjykatën e rrethit të Tiranës.

Neni 15

Çdo person që ka një interes legjitim për mbrojtjen e të miturit, mund të ndërhyjë në procesin e birësimit.

Neni 16

Kushtet dhe pasojat e birësimit të shpallur në Shqipëri përcaktohen nga legjislacioni Shqiptar. Birësimi nuk lejohet kur:

- Ky institut nuk njihet në shtetin ku banojnë birësuesit;
- Arrihet në përfundimin se birësimi është me pasoja të rënda për të miturit;
- I mituri në shtetin ku banojnë birësuesit nuk gëzon të njëjtat të drejta që njihen në Shqipëri.

Neni 17

Pranimi, kërkesa për marrje ose marrja e parave dhe e të mirave të tjera materiale nga ana e prindit, kujdestarit ose e çdo personi tjetër për vete a për të tretët në procesin e birësimit të një të mituri dënohen deri në 5 vjet heqje lirie.

Paratë ose të mirat e tjera materiale të përfituara i kalojnë shtetit dhe, në mungesë, i dënuari detyrohet të paguajë vlerën e barasvlershme.

Neni 18

Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për birësimin vendas me përjashtim të neneve 6, 9, 14, 16.

Neni 19

Çështjet e pezulluara në bazë të dekretit nr.146, datë 13.3.1992 "Për ndërprerjen e birësimit të të miturit shqiptar nga shtetas të huaj", gjykohen në bazë të dispozitave të këtij ligji.

Neni 20

Nenet 55 dhe 61 të ligjit nr.6599, datë 29.6.1982 "Për kodin e familjes të Republikës së Shqipërisë", dekreti nr.146, datë 13.3.1992 "Për ndërprerjen e birësimit të të miturit shqiptar nga shtetasit e huaj", si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.411, datë 4.1.1993, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.